

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E VUSHTRRIË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **644-26-728-5-5-8**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me inventar**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

| | |
|--|--------------------------------|
| Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj | WOOD CORPORATION L.L.C. |
| NUI | 811289562 |
| Adresa | Rr.Ukë Bytyqi |
| Vendi | Suharekë |
| Kodi postar | 23000 |
| Numri Telefonit | |
| Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj | Driton Gashi |
| Adresa elektronike | info@tenaseri.com |
| Data e parashtrimit të ankesës | 12.05.2026 |

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me inventar

Furnizim me inventar

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Është refuzuar si kinse e pabazuar

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 62 i LPP

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. Hyrje

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Vushtrrisë (tutje: Autoriteti Kontraktues), ka udhëhequr aktivitetin e prokurimit me titull: "*Furnizim me inventar*", me numër prokurimi 644-26-728-5-5-8 dhe numër të brendshëm 644-26-007-5-5-8. Operatori ekonomik "Wood Corporation" (tutje: Ankuesi), ka ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit duke i plotësuar të gjitha kushtet e ftesës për ofertim.

Autoriteti kontraktues, përkundër se ka pasur në dispozicion mostrat e produkteve të operatorit të rekomanduar të cilat nuk përputhen me specifikacionin teknik të kërkuar, përsëri ka rekomanduar këtë operator të papërgjegjshëm për dhënie të kontratës. Duke mbetur si palë e pakënaqur pjesëmarrëse në këtë aktivitet me procesin e vlerësimit, Ankuesi fillimisht ka paraqitur Kërkesë pranë autoritetit kontraktues me të cilën ka kundërshtuar dhënien e kontratës për operatorin ekonomik "*Mobelland*". Autoriteti kontraktues me një arsyetim të përgjithshëm ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si kinse të pabazuar dhe Ankuesi menjëherë ka parashtruar një Ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (tutje: OSHP).

OSHP me vendimin nr 2026/0174 me datën 22.04.2026 ka nxjerr vendim me anë të së cilit ka aprovuar në tërësi pretendimet ankimore të Ankuesit dhe ka detyruar Autoritetin kontraktues që lëndën ta kthej në rivlerësim.

Autoriteti kontraktues duke dështuar që të shpërblej me kontratë operatorin ekonomik të preferuar ka nxjerr një vendim me të cilin ka rekomanduar anulimin e aktivitetit të prokurimit, me një arsyetim skandaloz se kinse ka mungesë të mjeteve financiare dhe se është aprovuar lista e artikujve për përdorim të përbashkët që janë objekt i procedurës qendrore të prokurimit publik. Duke qenë se Ankuesi nuk pajtohej me këtë arsyetim dhe ka konsideruar se autoriteti kontraktues ka shmangur detyrimet në raport me ekzekutimin e vendimit të OSHP-së, brenda afatit ligjor ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim me pretendimet si në këtë ankesë.

Autoriteti Kontraktues me datën 30.04.2026 ka nxjerr vendim me anë të së cilit ka refuzuar kinse si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim dhe ka lënë në fuqi njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues. Duke mbetur thellësisht të pakënaqur me këtë vendim dhe arsyetimin e tij, Ankuesi brenda afatit ligjor paraqet këtë Ankesë pranë OSHP-së.

II. Nuk janë përmbushur kushtet ligjore për anulim të aktivitetit të prokurimit

Siç shihet nga të dhënat e aktivitetit të prokurimit, Ftesa për ofertim aktiviteti i prokurimit është iniciuar me datën 25.02.2026, që do të thotë se mjetet kanë qenë të zotuara në këtë vit dhe gjendja financiare e Komunës nuk ka mundur të ndryshoj në raport me këtë projekt përderisa mjetet kanë qenë të zotuara. Prandaj, ky arsyetim nuk mund të përdoret për anulimin e aktivitetit të prokurimit, pasi që nuk gjen mbështetje në Ligjin për Prokurimin Publik dhe as Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe Ligjin për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026.

Po ashtu me nenin 62 të Ligjit për Prokurimin Publik pas hapjes së ofertave nuk lejon anulimin e aktivitetit të prokurimit për një arsyetim të tillë. Kjo pasi që në nenin 62 përcakton: "*1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njëërën nga arsyet: 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit. 2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njëërën nga arsyet: 2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit [...]*"

Siç shihet nga dispozita e lartcekur arsyetimi mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk gjen asnjë mbështetje në arsyet se pse një aktivitet i prokurimit mund të anulohet pas hapjes së ofertave. Rrjedhimisht rezulton se autoriteti kontraktues e ka anuluar këtë aktivitet vetëm pse nuk ka mundur që ta shpërblej me kontratë operatorin të cilin kishte për qëllim.

Për këtë arsye Ankuesi konsideron se nuk mund të anulohet ky aktivitet i prokurimit në këtë fazë dhe se autoriteti kontraktues duhet të rishqyrtoj vendimin e vet në atë mënyrë që të bëjë vazhdimin e vlerësimit të ofertave në përputhje me obligimet ligjore sipas vendimit të OSHP-së.

Për më tepër nga vet komunikimi i zyrtarit të prokurimit me drejtorinë përkatëse siç shihet nga emailat e bashkangjitur vërehet sugjerimi për anulim të aktivitetit të prokurimit në bold me të cilin zyrtari i prokurimit përmes pyetjes i tregon njësisë kërkuese si të përgjigjen. Rikujtojmë se mos ekzekutimi i vendimeve përfundimtare administrative të organit epror, në këtë rast OSHP-së nuk është çështje me të cilën duhet bërë devijime.

Ky aktivitet zhvillohet në kuadër Kontratës publike kornizë të AQP-së me të cilën janë kualifikuar operatorët ekonomik për të zhvilluar procedura të mini-tenderit, andaj arsyetimi se ky aktivitet duhet të zhvillohet si prokurim i përbashkët është i pabazuar dhe qesharak. Pra është pikërisht AQP ajo që na ka kualifikuar për të zhvilluar këtë aktivitet të minitenderit.

Siç shihet nga dy arsyetimet e përdorura nga Autoriteti kontraktues vërehet kundërthënia në arsyet e përdorura për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Përderisa arsyetimi i parë është mungesa e fondeve, tek arsyetimi i dytë nuk mohohet se Autoriteti kontraktues

sërisht dëshiron të vazhdoj me këtë aktivitet të prokurimit, por theksohet se kjo do të bëhet në kuadër të kontratës së AQP-së. Do të thotë në të njëjtën kohë të dy këto arsye nuk mund të jenë të vërteta në të njëjtën kohë, pasi që mungesa e buxhetit do të nënkuptonte edhe pamundësi të ritenderimit me AQP apo cilindo autoritet tjetër.

Rrjedhimisht vlerësojmë se për panelin shqyrtues dhe ekspertin, rrethanat e këtij aktiviteti janë shumë të qarta, se autoriteti kontraktues dëshiron të mos zbatoj vendimet e këtij organi dhe për këtë paraqet arsyetime fiktive kinse nuk mund të bëjë vlerësimin e ofertave.

Duke marrë parasysh faktet e lartcekura me respekt i kërkojmë panelit shqyrtues që këtë ankesë ta aprovoj si të bazuar, të anuloj njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lëndën ta kthej në rivlerësim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

N/a

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*